



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 24

Prishtinë, më 19. 10. 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Fatmir Rexhepi – kryetar, Danush Ademi, Ibrahim Makolli, Hajredin Hyseni, Luljeta Shehu, Shpresa Murati dhe Drita Maliqi.

Munguan: Nerxhivane Dauti, dhe Ibrahim Selmanaj.

Pjesëmarrës të tjerë: Elita Vokshi dhe Lejla Selimi- OSBE, Isuf Zejna – KDI, Jetmir Bakija- NDI.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinator dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e drejtoi: Fatmir Rexhepi - kryetar.

Fatmir Rexhepi konstatoi se në bazë të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës ishin plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 5. 10. 2010,
3. Shqyrtimi i shkresës së Sindikatës së Pavarur e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës të Kosovës.
4. Shqyrtimi i amendamenteve të propozuara në Projektligjin për rezervat shtetërore të mallrave, nga aspekti i të drejtave të njeriut,
5. Shqyrtimi i amendamenteve të propozuara në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për blegtorinë e Kosovës, nga aspekti i të drejtave të njeriut,

6. Shqyrtimi i amendamenteve të propozuara në Projektligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme të komunës, nga aspekti i të drejtave të njeriut,
7. Kalendari i shqyrtimit dhe amendamentimit të Projektligjit për Personat e Pagjetur nga ana e grupit punues
8. Të ndryshme.

Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 05. 10. 2010

Komisioni e miratoi pa vërejte procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 05. 10. 2010

3. Shqyrtimi i shkresës së Sindikatës së Pavarur të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës të Kosovës.

Kryetari- Tha më lejoni t'ju njoftoj me kërkesën e sindikatës dhe shtoi se në korrik të këtij viti ka pranuar në bisedë përfaqësuesit e sindikatës, prej të cilëve ka marrë njoftimet lidhur me kërkesat e tyre, si dhe takimet që ka pasur Komisioni.

Ai lidhur me këtë pikë hapi debat.

Rreth formulimit të rekomandimeve diskutuan deputet: Ibrahim Makolli, Drita Maliqi dhe Hajredin Hyseni.

Komisioni njëzëri vendosi që Kuvendit të Kosovës t'ia paraqesë këto;

Rekomandime

- I. Bazuar në debatin lidhur me çështjen në fjalë Komisioni i rekomandon Kryesisë së Kuvendit, që çështja dhe situata e pensionistëve dhe invalidëve të punës të Kosovës të radhitet për debat në njërën nga seancat e radhës.

Komisioni, në bazë të vlerësimit i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës t'i miratojë propozimrekomandimet, si vijon:

- Parlamenti të kërkojë nga Qeveria të iniciohet përgatitja e projektligjeve lidhur me sistemin e pensionistëve dhe të invalidëve.
- Të shihet mundësia e ndryshimit dhe reformimit të skemës së pensioneve të menaxhuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe nevoja e veçimit të personave që me vite kanë kontribuar në Fondin e pensioneve të Kosovës.
- Të kërkohet nga Qeveria që të vendosë në prioritetet e zgjidhjes së çështjes lidhur me Fondin e pensionistëve të Kosovës gjatë takimeve dhe bisedimeve teknike.

Komisioni lidhur me rekomandimet vendosi të informohet Sindikata e Pavarur e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës të Kosovës.

4. Shqyrtimi i amendamenteve të propozuara në Projektligjin për rezervat shtetërore të mallrave, nga aspekti i të drejtave të njeriut,
5. Shqyrtimi i amendamenteve të propozuara në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për blegtorinë e Kosovës, nga aspekti i të drejtave të njeriut,
6. Shqyrtimi i amendamenteve të propozuara në Projektligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme të komunës, nga aspekti i të drejtave të njeriut,

Komisioni konstatoi se Projektligji për rezervat shtetërore Projektligji, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për blegtorinë dhe Projektligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme të komunës, janë në pajtueshmëri me Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Deklaratën Universale për të drejtat e njeriut, Konventën për eliminimin të gjitha formave të diskriminimit dhe nuk i cenonjë parimet e përgjithshme dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, prandaj mund të procedohen për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

7 Kalendar i shqyrtimit dhe amendamentimit të Projektligjit për Personat e Pagjetur nga ana e grupit punues,

Kryetari tha se Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, në mbledhjen e mbajtur më 19. 10. 2010 e shqyrtoi procedimin e Projektligjit për personat e pagjetur. Në bazë të vendimit të mbledhjes së Komisionit të datës 05. 10. 2010, i përcaktoi fazat dhe dinamikën e amendamentimit të Projektligjit si vijon:

a) Faza e parë

10 (dhjetë) ditë grupi i zgjeruar i punës i shqyrton rekomandimet e dala nga debati publik dhe jep propozime për ndryshime në Projektligj.

b) Faza e dytë

10 (dhjetë) ditë grupi i punës i deputeteve i përgatit propozimamendamentet dhe ia procedon Komisionit.

c) Faza e tretë

Komisioni, në bashkëpunim me komisionet e tjera, i përgatit amendamentet dhe ligjet e tjera deri në miratimin përfundimtar.

8 Të ndryshme.

Shqyrtimi i petitionit të grupit joformal të grave të komunës së Fushë - Kosovës. Komisioni e shqyrtoi Peticionin e grupit joformal të grave nga Fushë - Kosova dhe vendosi t'ia dërgojë për shqyrtim në Komisionin Funksional.

Mbledhja përfundoi në orën 13. 40

Kryetari i Komisionit

Fatmir Rexhepi

